



KONFERENCA
Diaspora Flet

ORGANIZATAT JO-QEVERITARE
DHE FILANTROPIA E
DIASPORËS SHQIPTARE

PLANI I VEPRIMIT PËR FILANTROPINË E DIASPORËS MAJ 17-20, 2018

Krijimi i një fondacioni global shqiptar

QËLLIMI

Qëllimi i këtij komponenti të Planit të Veprimit nga Germin është themelimi dhe zhvillimi i Fondit Global Shqiptar (FGSH) i cili do të promovojë Filantropinë Shqiptare në Diasporë që do të mbështesë organizatat jo-fitimprurëse në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor ku jetojnë shqiptarët. Gjithashtu kemi si qëllim të zhvillojmë një përqasje më të decentralizuar që i përket shekullit 21, krahasuar me përqasjen tradicionale të shekullit të kaluar e cila ishte e centralizuar.

SYNIMET TONA

A. Krijimi i Fondit Global Shqiptar (FGSH) në SHBA dhe së paku në një shtet tjetër në Bashkimin Europian që të bëjë mbikëqyrjen e donacioneve nga shqiptarët anë e mbanë botës, për organizatat jo-fitimprurëse në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Malin e Zi dhe Serbinë Jugore.

B. Zhvillimi i një platforme digjitale të filantropisë për mbledhjen e fondeve përmes së cilës komuniteti global shqiptar do të mund të kontribuojë direkt tek organizatat dhe projektet që ata dëshirojnë t'i mbështesin, bazuar në vendndodhjen, sektorin apo çfarëdo kriteri tjetër që ata e konsiderojnë të rëndësishëm.

C. Në një periudhë më afatgjate të shndërrohet në një fondacion të madh humanitar me disa donatorë të fuqishëm shqiptarë dhe jo-shqiptarë (individë dhe korporata) që do të shërbejë si Fondacion Këshillëdhënës për Donatorët dhe do të shpërndajë grante të vogla e të mëdha për organizatat meritore jo-fitimprurëse në Ballkanin Perëndimor.

FGSH do të ndihmonte organizatat jo-fitimprurëse të mbledhin fonde si më poshtë vijon:

1. Ofrimin e një link-u të besueshëm nga një organizatë e bazuar në diasporë (FGSH), që do të ishte e besueshme prej donatorëve të mundshëm nga Diaspora Shqiptare (dhe të huaj) për të shqyrtuar organizatat donatore lidhur me besueshmërinë, kompetencën, ndikimin dhe transparencën e tyre.
2. Ofrimin e një mekanizmi për marrjen e donacioneve online për të gjitha organizatat jo-fitimprurëse të Ballkanit Perëndimor që aktualisht nuk ekziston,

duke mundësuar dukshëm dhënien e donacioneve dhe uljen e kostove të Filantropisë së Diasporës (duke filluar nga Tarifa prej 1% për donacionet); dhe

3. Ofrimin e një mekanizmi për donatorët nga Diaspora Shqiptare që të kenë avantazhe për zbritjen nga taksat, gjë të cilën nuk mund ta kenë kur bëjnë donacione direkte tek organizatat jo-fitimprurëse në Ballkanin Perëndimor.

PROFILI

Kombi Shqiptar numëron rreth 10 milionë njerëz të shpërndarë në shumë shtete, dhe një përqindje e lartë e tyre jeton jashtë vendit të tyre të origjinës -- Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të zi dhe Serbisë. Si përqindje e popullatës së tërësishme, padiskutim që është Diaspora më e madhe e ndonjë vendi Europian, dhe njëra nga më e madhja në botë me mbi 25% të popullatës të emigruar në 25 vitet e fundit.

Historikisht, kontributi më i madh financiar i Diasporës, është bërë përmes remitancave. Sidoqoftë, remitancat kanë rënie drastike mbi 50% në 5-10 vitet e fundit, pasi Diaspora është vendosur më shumë jashtë Kosovës dhe Shqipërisë. Është e mundshme që të ketë rënie edhe më të madhe përderisa Diaspora Shqiptare vazhdon të jetojë jashtë vendeve të origjinës së tyre.

Është e rëndësishme për t'u vënë në dukje se për shkak të nivelit të lartë të të ardhurave në vendet e emigrimit, krahasuar me vendin e origjinës, padyshim që pasuria më e madhe shqiptare është e përqendruar në Diasporë. Lind pyetja, si të tërheqim një pjesë të kësaj pasurie prapa në rajon, që të promovojmë zhvillimin ekonomik e social në shekullin 21.

Filantropia e Diasporës Shqiptare është një mekanizëm i këtij lloji. Shqiptarët në Diasporë nuk janë të prirur për të investuar shuma të mëdha të pasurisë së tyre në vendet e origjinës duke qenë se rreziku i investimit është i madh, dhe se ato banojnë shumë larg për të pasur kohën e nevojshme për të mbikëqyrur investimet -- mirëpo shumë prej tyre kanë dëshirën dhe vullnetin që të dhurojnë me qindra apo mijëra dollarë tek organizatat në vendet e tyre të origjinës, sidomos kur tani Diaspora Shqiptare numëron miliona shqiptarë që jetojnë në klasën e mesme të shoqërisë në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

METODOLOGJIA

Ne besojmë shumë se sektori jo-fitimprurës në Ballkanin Perëndimor luan një rol kritik në fuqizimin dhe ecjes në rritje të zhvillimit ekonomik, shoqëror e social të vendeve përkatëse. Megjithatë, organizatat jo-qeveritare në Shqipëri po marrin çdo herë e më pak mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve, ndërkohë që vendet në rajon vazhdojnë të zhvillohen. Si rrjedhim, mbështetja nga ana e shqiptarëve që jetojnë

jashtë, do të jetë vitale për plotësimin e nevojave të organizatave jo-fitimprurëse që u shërbejnë shqiptarëve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbinë Jugore.

Përmes krijimit të një organizate sikurse do të jetë Fondacioni Global Shqiptar (FGSH), ne do të krijojmë mekanizmin e nevojshëm institucional për ata njerëz që nuk e ndjejnë më nevojën e dërgimit të remitançave në vendin e tyre të origjinës. Në të njëjtën kohë ata do të ofronin mbështetje financiare për organizatat jo-fitimprurëse që sipas të gjitha gjasave pritet të kenë rënie të burimeve të zakonshme të të ardhurave prej donatorëve ndërkombëtare prej të cilëve janë mbështetur gjatë 2-3 dekadave të fundit.

Në Gusht 2015, Massachusetts Albanian American Society (MAASBESA) dhe Albanian American Women's Organization – Motrat Qiriazi (AAWO) deklaruan partneritetin e tyre për zhvillimin e Fondacionit Global Shqiptar (FGSH), financuar nga shqiptarët që jetojnë jashtë vendeve të tyre të origjinës dhe të tjerë që dëshirojnë të mbështesin organizatat shqiptare jo-fitimprurëse. Gjatë asaj kohe, mbi 20 donatorë u zotuan për dhënien e \$1,000 secili, dhe 17 organizata pranuan grante prej \$1000 secila (Shikoni Shtojcën për listën e plotë të organizatave -- 7 në Shqipëri, 7 në Kosovë, 2 në Malin e Zi dhe 1 në Maqedoni) .

Në dy vitet e fundit, FGSH ka pasur një ngrirje të aktiviteteve, duke pritur kohën e duhur për ta shpallur idenë -- të cilën mendojmë se i ka ardhur koha tashmë në vitin 2018. Angazhimi i diasporës mbarë-shqiptare përmes këtij propozimi për Fondin Global Shqiptar (FGSH) do të mbështesë OJQ-të Shqiptare, dhe do të ndihmojë në ofrimin e financimit të qëndrueshëm për të pasur ndikim të lartë dhe përjasje të reja në mbështetje të nismave sociale-ekonomike dhe qytetare.

PLANI I PUNËS QË PROPOZOJMË

Plani ynë i punës është i ndarë në 3 faza si më poshtë:

Faza 1: Themelimi ligjor i Fondacionit Global Shqiptar (FGSH) (Maj 2018 - Dhjetor 2018)

Faza 2: Zhvillimi i Filantropisë së Diasporës Shqiptare (Janar 2019 - Dhjetor 2020); dhe

Faza 3: Zhvillimi i Programeve për grante të vogla dhe të mëdha (Janar 2021 dhe më tej).

Si krahasim, FGSH do të jetë i ngjashëm dhe i krijuar në bazë të përvojave të ngjashme të organizatave filantropike të diasporave tjera, si p.sh. Turkey Mozaik Foundation i cili u themelua në vitin 2017 në Britaninë e madhe ose Diaspora CrowdFunding and Philanthropy Program i krijuar nga Diaspora e Izraelit.

Faza 1: Themelimi ligjor i Fondacionit Global Shqiptar (FGSH) (Maj 2018-Dhjetor 2018)

1. Themelimi dhe regjistrimi ligjor i FGSH në SHBA dhe së paku në një shtet në Europë (momentalisht FGSH është një iniciativë e Massachusetts Albanian Society dhe Albanian American Women's Organization, por nuk është ligjërisht një organizatë e veçuar prej tyre);
2. Krijimi i Bordit të Drejtorëve për FGSH që do të ishte i përbërë nga 10-15 individë, dhe një Bord Këshillues që do të ishte i përbërë nga një numër i njëjtë i personave që vijnë nga shtete të ndryshme (Shqipëri, Kosovë, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Greqia Italia, Gjermania, Zvicra, Austria, Britania e Madhe, Turqia, Australia, Kanada, SHBA etj...);
3. Hartimi dhe miratimi i rregullave të brendshme të organizatës që do të përdoren për qeverisjen e veprimeve nga FGSH;
4. Hartimi i udhëzimeve që përcaktojnë kushtet që duhen përmbushur prej organizatave jo-fitimprurëse në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, dhe Serbi, që të kenë mundësinë të marrin pjesë në platformën digjitale të mbledhjes së fondeve gjatë Fazës 2 në vitin 2019.
5. Hartimi i udhëzimeve që përcaktojnë kushtet që duhen përmbushur lidhur me dërgimin e fondeve tek organizatat shqiptare dhe tabela e tarifave për shërbimet që ofrohen nga FGSH si një qendër e Filantropisë së Diasporës që mbështet organizatat jo-fitimprurëse shqiptare.
6. Hartimi i një pyetësori të detajuar digjital për Filantropinë e Diasporës Shqiptare, i cili do të bënte analizën sipas interesave gjeografikë dhe sipas sektorëve të donatorëve dhe filantropistëve të mundshëm dhe nivelet e mundshme të donacioneve që të na lehtësojë dhe përmirësojë qasjen tonë drejt tyre si p.sh. <https://www.surveymonkey.com/r/Indiaspora-AIF>; dhe
7. Të fillohet me disa fushata për ngritje fondesh në shkallë të vogël, nëpërmjet platformave digjitale, për promovimin e FGSH-së dhe 2-3 organizatave të përzgjedhura. (ngjajshëm me Facebook kampanjën për mbledhjen e fondeve të mbajtur nga Massachusetts Albanian American Society for Action for Mothers and Children in Kosovo në Mars 2018.

Faza 2: Zhvillimi i Filantropisë së Diasporës Shqiptare (Janar 2019 - Dhjetor 2020)

Për Fazat 2 dhe 3 ne po rendisim një numër aktivitete të mundshme për të treguar vizionin tonë të përgjithshëm. Është shumë herët për të zhvilluar ide më të detajuara, së paku derisa të përmbushet Faza 1. Ne mendojmë që të fillojmë duke u përqendruar në mbledhjen e shumave të vogla deri në €1,000 për donator, dhe pastaj gradualisht të kërkojmë donatorë më të mëdhenj prej €5,000 dhe më shumë - dmth, duke filluar me

shuma të vogla me numër të gjerë donatorësh (qasja e shekullit 21) në vend që të fillojmë me shuma të mëdha nga një numër i vogël donatorësh (qasja e shekullit 20).

1. Bazuar në kriteret e zhvilluara në Fazën 1, zgjedhja deri në 100 organizata jo-fitimprurëse shqiptare që i përmbushin kushtet për të marrë pjesë në fushatat online (vini re se mbi 60 organizata kanë aplikuar për financim nga FGSH në 2015/2016);
2. Hartimi i profileve të detajuara për çdo projekt ose organizatë që do të marrë pjesë në fushatat online që parashtrojnë nevojën për shërbimet e ofruara nga organizata dhe të dëshmojnë për potencialin e tyre për rritje;
3. Krijimi dhe zbatimi i fushatave javore ose mujore të "mbledhjes së fondeve online" (Crowdfunding) përmes website dhe të mediave sociale të ngjashme me Kosovo Ideas që mund të mbledhnin të paktën \$100,000 në vit gjatë dy viteve të para;
4. Zhvillimi i partneriteteve me organizata ndërkombëtare të angazhuara në filantropinë e diasporës, siç janë Charities Aid Foundation America në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada, që kanë krijuar programin Diaspora Gives Bangladesh dhe Rrjeti i Dhënies së Fondeve në Mbretërinë e Bashkuar që ka bashkëpunuar me Romanian Diaspora, në mënyrë që të rrisim më tej shtrirjen tonë dhe nivelin e sofistikimit;
5. Ngritja e fondeve shtesë për veprime përmes granteve të vëna në dispozicion nga donatorët ndërkombëtarë që promovojnë filantropinë e diasporës (p.sh, USAID, GIZ) duke përfshirë ato që do të mbështesin monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit dhe suksesit të projektit; dhe
6. Krijimi i Fondit të Zhvillimit për FGSH si një mënyrë për të angazhuar filantropinë e nivelit të lartë nga individë dhe korporate me te ardhura të larta dhe të mesme që ndodhen në Diasporën Shqiptare dhe në Ballkanin Perëndimor.

Faza 3: Zhvillimi i Programeve të Granteve të Vogla dhe të Mëdha (Janar 2021 dhe më Tej)

1. Duke u bazuar në Fazën 2, sigurimi i donacioneve në vlerë prej së paku \$100,000 secili nga së paku 10 donatorët më të pasur, për të mundësuar që FGSH të funksionojë si një Fondacion Këshillëdhënës për Donatorët;
2. Bazuar në shumën e parave të ngritura të zhvillohet një program për grante të vogla (deri në €10,000) dhe një program për grante të shkallës së lartë (deri në €100,000); dhe

3. Bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë që do të dëshironin të bashkë-financonin programe të shoqërisë civile dhe organizatave jofitimprurëse.

BUXHETI

Eshtë pak herët për të përgatitur një buxhet të detajuar deri sa të marrim reagime nga anëtarët e Diasporës dhe donatorët e mundshëm, por ne mendojmë se një buxhet i përafërt mund të jetë diku rreth €20,000 - €30,000 për Fazën 1 në vitin 2018, dhe në të ardhmen mund të përcaktohen fonde të tjera shtesë.

DRAFT

Annex

List of Approved GAF Small Grants for 2016 December 28, 2015

Shqipëri

1. Albanian Socio Economic Think Tank
2. Dev-Aid Organization
3. Down Syndrome Albania
4. Megaphone Association
5. Regional Development Agency Vlora
6. Së Bashku Foundation
7. Shoqata e Gruas Shpresa Fushe Arrez

Kosovë

1. Arta
2. Autizmi Flet
3. Gruaja Hyjnore
4. Mother Theresa Society
5. Qendra Rinor Dragash
6. Shoqatae të drejtave të pacientëve në Kosovë- PRAK
7. Zana

Magedoni

1. Shoqata Hotla Macedonia

Mal të Zi

1. Une Veproj Montenegro
2. New Horizons Foundation Montenegro

Themeluesit e Fondacionit Global Shqiptar -- Dhjetor 28, 2015**Bordi i drejtorëve**

1. Dr. Mark Kosmo, Chair of MAASBESA (Chair of GAF)
2. Dr. Anna Kohen, President of AAWO (Vice-Chair of GAF)
3. Ms. Esmeralda Mosko, Board Member of AAWO (Treasurer of GAF)
4. Ms. Albana Orgocka, Choate, Hall & Stewart, LLP
5. Mr. Alban Pruthi, The World Bank Group

Bordi këshillues

1. Dr. Lisa V. Adams, Geisel School of Medicine at Dartmouth
2. Ms. Beti Beno, Esq., Marku, Beno and Tsamblakos, PLLC
3. Mr. Cafo Boga, Albanian American Development Foundation
4. Ambassador Vjosa Dobruna, Embassy of Republic of Kosovo in Netherlands
5. Dr. Artur Elezi, American University
6. Dr. Ermal Frasheri, Harvard University
7. Mr. Ardian Gjoka, Gjoka Law Firm, PLLC
8. Ms. Nita Gojani, UN Women in Prishtina
9. Ms. Eliza Hoxha, University of Prishtina
10. Ms. Etrita Ibroci, Kepler Chevreux
11. Dr. Veton Latifi, South-East European University in Tetovo
12. Mr. Arben Malaj, Institute for Public Policy and Good Governance
13. Dr. Martha Muco, General Dynamics Information Technology
14. Mr. Avni Mustafaj, National Albanian American Council
15. Mr. Mentor Nazarko, Independent Journalist and Writer
16. Dr. Bernard Nikaj, University of Prishtina
17. Mr. Ergys Prenika, WestRock Company
18. Ms. Klementina Sula, Henry Ford Health System
19. Ms. Viola Trebicka, Quinn Emanuel Urquhart & Sullivan, LLP
20. Mr. Ermal Vila, The World Bank Group
21. Mr. Behar Xharra, United Nations Development Programme

Anëtarët themelues -- Donacione prej \$1000

Alban Nevzati	Anna Kohen
Arben Malaj	Beti Beno
Berti Pashko	Bleron Baraliu
Cafo Boga	Dynamics Partners Tirana (Monika Farka)
Eliza Dushku	Ergys Prenika
Ermelinda Laho	Louis Foundos
Mark Kosmo	Martha Muco
Perparim Kalo Associates (Perparim Kalo)	Peter Pochi



DIALOGU I STRUKTURUAR PËR TË
DREJTAT E DIASPORËS

Richard Lukaj
Shpresa Xhaki
Valbona Sherifi

Shkumbin Qerimi
Sigal Uniqa Group Austria (Avni Ponari)
Valon Xharra

DRAFT